

VENDIM
Nr. 150, datë 1.4.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 84, DATË 4.3.2021, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 1.4.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 84, datë 4.3.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë), me shkresat nr. 8647 prot., datë 25.5.2021, me lëndë “Mbi pajisjen e shoqërisë me aktmiratime higjieno-sanitare”, nr. 4910 datë 11.3.2022, me lëndë “Kërkesë për modifikim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për zgjerimin e zonës së shërbimit, aktmiratimet higjieno-sanitare, në të cilat përfshihen njësitë e tjera administrative Baldushk, Pezë, Farkë, Bërzhitë dhe Krrabë, që kishin mbetur jashtë zonës së shërbimit të kësaj shoqërie.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit të UK Tiranë, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Tiranë, me vendimin nr. 84, datë 4.3.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.” me një afat 2-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

1. Njësia Administrative nr. 1;
2. Njësia Administrative nr. 2;
3. Njësia Administrative nr. 3;
4. Njësia Administrative nr. 4;
5. Njësia Administrative nr. 5;
6. Njësia Administrative nr. 6;
7. Njësia Administrative nr. 7;
8. Njësia Administrative nr. 8;
9. Njësia Administrative nr. 9;
10. Njësia Administrative nr. 10;

11. Njësia Administrative nr. 11;
 12. Njësia Administrative Dajt;
 13. Njësia Administrative Kashar;
 14. Njësia Administrative Ndroq;
 15. Njësia Administrative Petrelë;
 16. Njësia Administrative Shëngjergj;
 17. Njësia Administrative Vaqarr;
 18. Njësia Administrative Zall Bastar;
 19. Njësia Administrative Zall Herr.
4. KKRR-ja, në vendimin nr. 84, datë 4.3.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.” i rekomandoi shoqërisë UK Tiranë, që të punonte në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë të të gjithë zonës së shërbimit me aktmiratim higjieno-sanitar;
5. Akt miratimet higjieno-sanitare për zonën e shtuar janë, si më poshtë:

Nr.	Njësitë administrative që i shtohen zonës së shërbimit	Aktmiratimi higjieno-sanitar
1	Bërzhitë	Nr. 151, datë 10.5.2021, “Stacion pompimi”
2	Farkë	Nr. 148, datë 10.5.2021, “Depo uji”
3	Baldushk	Nr. 746, datë 23.11.2021, “Stacion pompimi”
4	Krrabë	Nr. 747, datë 23.11.2021, “Depo uji”
5	Pezë	Nr. 751, datë 25.11.2021, “Stacion pompimi”, Grecë

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit të KKRR-së nr. 84, datë 4.3.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

“Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a. është Bashkia Tiranë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani